



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulaganja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments

REFERENCË:	06			
PËR/ZA/TO:	Z. Xhelal Dërguti, GIZ			
CC:				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Shyhrete Gosalci, u.d. Sekretare e Përgjithshme në MDIS			
NGA/OD/FROM:	Z. Behar Isma, kryesues i grupit të punës për hartimin e Projektstrategjisë për Diasporën 2019-2023, MDIS			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për angazhimin afatshkurtër të një eksperti nga diaspora, përmes programit të angazhimit të ekspertëve të diasporës nga GIZ-i			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Rr. “Zenel Salihu”, Prishtinë 038-200-17-001	Data: Datum: Date:	7.5.2018
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION				X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION				X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE :				X

I nderuari z. Dërguti,

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS), në kuadër të planit të punës për vitin 2018, ka planifikuar hartimin e politikave afatmesme pesëvjeçare (5), përkatësisht Projektstrategjinë për Diasporën 2019-2023 dhe planin e veprimit 2019-2021.

Në këtë kontekst kemi parasysh programin për angazhimin afatshkurtër të ekspertëve nga diaspora, të cilin e prezantuat në takimin që kishim me misionet e huaja që veprojnë në Kosovë, të cilat në fushëveprimin e tyre, në mënyre direkt ose indirekte, kanë migrimin dhe zhvillimin (takim ky i mbajtur më 13 mars 2018, në zyrën e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike).

Përmes kësaj kërkesë kërkojmë që, mundësisht, përmes programit tuaj të angazhimit afatshkurtër të ekspertëve, në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë për Diasporën 2019-2023 dhe Planit të Veprimit 2019-2021, të angazhojmë një ekspert nga diaspora, në periudhën prej 1 qershorit deri në fund të nëntorit 2018.

Detyrat e tij do të jenë: mbështetja e kryesuesit të grupit të punës gjatë takimeve, mbledhja e informatave nga grupi i punës/nëngrupet, përgatitja e shkresave, memorandumeve shpjeguese, si dhe, në bashkëpunim me kryesuesin e grupit të punës, hartimi i draftit fillestar të Projektstrategjisë për Diasporën 2019-2023 dhe Planin e Veprimit 2019-2021.

Termet e referencës për angazhimin e ekspertit nga diaspora:

1. Të ketë të kryer Fakultetin e Juridikut ose Shkencat Politike;
2. Të ketë njohuri të mira në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe, gjermane dhe asaj angleze;
3. Të ketë përvojë relevante në hartimin e politikave ose punë në zyrë me çështje ligjore;
4. T'i ofrojë mbështetje teknike dhe profesionale kryesuesit të grupit të punës në procesin e hartimit të Strategjisë për Diasporën 2019-2023 dhe Planin e Veprimit 2019-2021.
5. Të përgatitë njoftime për takime të grupeve të punës dhe të nëngrupeve, memorandume shpjeguese dhe shkresa të tjera të nevojshme në kuadër të procesit të hartimit të Projektstrategjisë për Diasporën 2019-2023.
6. Të mbledhë informata nga grupi i punës/nëngrupet lidhur me hartimin e Projektstrategjisë për Diasporën.
7. Në bazë të informatave të mara nga grupi i punës/nëngrupet, në bashkëpunim me kryesuesin, ta hartojë draftin fillestar të Projektstrategjisë për Diasporën 2019-2023.

Behar Isma

Kryesues i grupit të punës për hartimin e
Strategjisë për Diasporën 2019-2023